



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, , Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar si dhe bazuar në Rregulloren për integrimin e të huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për integrimin e të huajve si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E LIPJANIT 2023-2025

Neni 1

MIRATOHET, Plani komunal i veprimit për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal i veprimit për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Lipjanit 2023-2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra Lokale e Komunës për Komunitete.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Nr. 15-561/02-33611

Lipjan, më 30.06.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

